

20162024523

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 25 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

**VENDIM PËR TËRHEQJEN NGA QARKULLIMI TË KARTËMONEDHAVE ME
VLERË NOMINALE 5000 DENARË**

1. Kartëmonedhat me vlerë nominale 5000 denarë (emetim I/96), të cilat janë në qarkullim nga data 8 shtator i vitit 1996, tërhiqen nga qarkullimi, duke i këmbyer ato falas me kartëmonedha dhe monedha të tjera në shumë ekuivalente.
2. Kartëmonedhat nga paragrafi 1 i këtij vendimi, pushojnë së qenuri mjet ligjor për pagesë, nga data 15 dhjetor i vitit 2016.
3. Kartëmonedhat nga paragrafi 1 i këtij vendimi do të këmben nga data 15 dhjetor i vitit 2016 deri më datë 28 shkurt të vitit 2017. Këmbimi do të bëhet nga bankat e themeluara në Republikën e Maqedonisë.
4. Nga data 1 mars i vitit 2017, këmbimi i kartëmonedhave nga paragrafi 1 i këtij vendimi do të kryhet në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe do të zbatohet nga data 15 dhjetor i vitit 2016.

Nr.V. 02-15/XII-4/2016
3 nëntor viti 2016
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov